

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“AVATARS “ Sh.P.K.

Sot më datë 12.05.2020, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, ne të nënshkruarit **Enea Koçi** dhe **Hasan Fatih Sürücü** shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë "AVATARS" sh.p.k. si më poshtë vijon:

KREU I

TE DHENAT E SHOQERISE

NENI 1

Data e Themelimit, Emri Forma, dhe Themeluesit

- 1.1 Sot, në datë 12.05.2020, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "AVATARS " SH.P.K..
- 1.2 Shoqëria është Person Juridik Privat dhe një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.3 Shoqëria do të paraqitet me emrin " AVATARS " Sh.p.k. Ky emërtim është i vetmi i shoqërisë dhe përdoret në të gjitha regjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me të tretet apo shtetin dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.4 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.5 Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj identifikuese, në formën e përcaktuar nga Ortaket e shoqërisë.
- 1.6 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.
- 1.7 Themeluesit e shoqërisë janë :
 - I. **Enea Koçi**, i biri i Petraq-it, i datëlindjes 06.07.1989, lindur në Lushnjë, dhe banues në Lushnjë në adresën: 9001, Lushnje L. Skënder Libohova, Rr. »Misto Mame« 050 03 18, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me Nr.030883173 dhe Nr.Personal I95706121O, lëshuar më datë 01.04.2011, shtetas Shqiptar, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar ;
 - II. **Hasan Fatih Sürücü**, i biri i Durmus-it, i datëlindjes 05.05.1975, lindur në Ankara (Turqi) dhe banues në Tirane, Njesia Bashkiake Nr 7, Rruga "Naim Frasheri" banesë private, 0 055, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 031766859 dhe nr. Personal H50505293N, lëshuar më datë

Enea Koçi
Enea Koçi

Hasan Fatih Sürücü
Hasan Fatih Sürücü

17.05.2012, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar, njohes i gjuhës shqipe;

Të cilët kanë vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 2

Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Regjistrimi dhe administrimin e faqeve të internetit (website) për shitjen e produkteve jo-ushqimore dhe ushqimore on line dhe jo online, në Shqipëri dhe jashtë saj; Programim i faqeve internet (WebDesign-Development) si dhe mirëmbajtjen e tyre, shërbime konsulence dhe marketingu, menaxhim i aktiviteteve në lidhje me to; Import - eksport dhe/ose prodhimi i produkteve të çfarëdo lloji; Shitja me shumicë dhe/ose pakicë e produkteve jo-ushqimore; Magazinimi dhe ruajtja e produkteve; Transport i mallrave brenda dhe jashtë vendit; Tregti me shumicë dhe pakicë e librave artistike dhe shkollorë; Realizimi i shitjeve online nëpërmjet disa Web-Portaleve; Konsulence dhe Trajnime të ndryshme në fushën e Marketing-ut; Zhvillim tregtie nëpërmjet website-t online sipas konceptit Market-Place; Tregti të ndryshme me shumicë dhe pakicë; Shitje online dhe jo online të të gjitha produkteve si argjendari dhe ora elektronike; Fëmijë & Lodra, Kancelari; Kujdesi Personal, Kremra të ndryshme dhe parafarmacia si aparat tensioni termometer etj.; Kompjuter & Celularë; Shtëpia -Dhomë Gjumi; Elektroshtëpiake të vogla -Enë Kuzhine, Tapete; Veshje & Fashion; Tregtimin e të gjitha llojeve të artikujve dhe marreveshjeve që i lejon ligji.

NENI 3

Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.


NENI 4

Selia e Shoqërisë dhe degët

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. "Peti", Pll.1, H.1, Ap. 1, 1061, Tiranë.
- 4.2 Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendim të asamblesë të Ortakëve të Shoqërisë.
- 4.3 Shoqëria ka të drejtë të operojë me zyrë, filiale, degë apo agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë apo dhe jashtë vendit.
- 4.4 Zyrat, filiale, degët apo agjensitë krijohen me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë, të cilët organizojnë punën dhe emëron organet drejtuese dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

Enea Koçi
Enea Koçi

H. F. Supreni



- 4.5 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :
e_mail: admin@avatars.al
nr.Cel: 0694617252

KREU II KAPITALI THEMELTAR

Neni 5

Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 (*dhjetë mijë*) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- a) Ortaku themelues **Enea Koçi**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 7.500(*shtatë mijë e pesëqind*) Lekë që përben **75%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues **Hasan Fatih Sürücü**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 2.500 Lekë (*dy mijë e pesëqind*) që përben **25%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.2 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit


- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, përmes emërimit të një eksperti të autorizuar dhe licensuar për të vlerësuar keto kontribute, me vendim të asamblese së shoqërisë, sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, vendimet merren me **2/3** e kuotave pjesëmarrëse
- 6.3 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë sipas pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Enea Koçi
Enea Koçi

H.A. Sürücü


- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjerë jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - ç) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - gj) riorganizimin dhe shpërndarjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 8.7 Të gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqërisë regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 8.8 Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

Enea Koci
Enea Koci

A. R. S. S. S. S. S.
/dm

- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkrim apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe ju dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Asambleja e përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
- 9.3 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilesuar, sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që përfaqësojnë me shumë se gjysmën e kuotave të kapitalit të shoqërisë janë të pranishëm personalisht, dhe votojnë me shkrim apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


Neni 11

Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me miratimin e shumicën e 2/3 (dy të tretave) të ortakëve të shoqërisë të pranishëm me të drejtë vote për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërndarjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve

Enea Koçi
Enea Koçi

H. P. S. S. S.



- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorit, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.1 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

KREU IV

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË


Neni 13


Administrimi


- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- 13.2 Afati i emërimit, është **5 vjet**, me të drejtë ripërsëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 13.3 Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratorë i shoqërisë:
Hasan Fatih Sürücü, i biri i Durmus-it, i datëlindjes 05.05.1975, lindur në Ankara (Turqi) dhe banues në Tirane, Njesia Bashkiake Nr 7, Rruga "Naim Frasheri" banesë private, 0 055, mbajtës i Leternjoftim ID nr. 031766859 dhe nr. Personal H50505293N, lëshuar më datë 17.05.2012, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, njohes i gjuhës shqipe, e_mail: admin@avatars.al, Nr.Cel: 0694617252;



(emër, mbiemër, firmë)



Enea Koçi




Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të veprojë si më poshtë vijon:
- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave e të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) të përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - e) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratori është i detyruar të kërkojë mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% (pese për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% (pese për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 14.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 14.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.


Neni 15

Përgjegjësia e Administratorit

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve në fuqi dhe të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Enea Koçi
Enea Kuci

G. R. Shari



- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakëve/ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare“, administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt dhe sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
- 15.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- 15.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Enea Koçi

Enea Koçi

A. P. S. S. S. S. S.



KREU V
VITI FINANCIAR – EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar

16. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

- 17.1 Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 17.2 Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar dhe miratuar mbi bazen e te drejtes vendimmarrese qe ka.

KREU VI


SHPERNDARJA – RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 18

Shperndarja dhe likuidimi

- 18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - d) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo me shume likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.
- 18.3 Shperndarja e shoqerise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Enea Koçi
Enea Koc

H. F. S. S. S. S.


- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje
18.5 Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë – Bashkimi - Ndarja

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër i posacem në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

- 21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 22

Fitimi që shperndahet

Koha, menyra dhe shuma e fitimit që shperndahet vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë, sipas raportit të administrimit në përputhje me këtë Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e nënshkrimit nga Ortaket e shoqërisë.

Hasan Fatih Sürücü, shtetas shqiptar, dhe me kombesi turke, nënshkruan në këtë statut, deklaron nën përgjegjësinë e tij, se është njohës i gjuhës shqipe.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"AVATARS" SH.P.K.

Enea Koçi

Enea Koçi

Enea Koçi

Hasan Fatih Sürücü

